

LIGJ

Nr. 8909, date 6.6.2002

PER RATIFIKIMIN E KONVENTES NR.177 "PUNA NE SHTEPI, 1996" TE ORGANIZATES NDERKOMBETARE TE PUNES

Ne mbeshtetje te neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 te Kushtetutes, me propozimin e Keshillit te Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet Konventa nr. 177 "Puna ne shtepi, 1996" e Organizates Nderkombetare te Punes.

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3375, date 24.6.2002 te Presidentit te Republikes se Shqiperise, Rexhep Meidani

KONVENTA Nr. 177

KONVENTA LIDHUR ME PUNEN NE SHTEPI

Konferenca e pergjithshme e Organizates Nderkombetare te Punes, e thirrur ne Gjeneves nga Keshilli Administrativ i Zyres Nderkombetare te Punes, dhe e mbledhur me 4 qershor 1996 ne sesionin e saj te 93-te,

-Duke sjelle ne kujtese qe shume konventa dhe rekomandime nderkombetare te punes, qe percaktojne norma te zbatimit te pergjithshem lidhur me kushtet e punes, jane te zbatueshme per punonjesit ne shtepi,

-Duke nenvizuar se kushtet e veçanta te punes ne shtepi e bejne te deshirueshme permiresimin e zbatimit te ketyre konventave dhe rekomandimeve ndaj punonjesve ne shtepi dhe plotesimin me norma te cilat te mbajne parasysh karakteristikat e kesaj pune,

-Pasi ka vendosur te miratoje propozime te ndryshme lidhur me punen ne shtepi, çeshtje qe

perben piken e katert te rendit te dites te sesionit,

Pasi ka vendosur qe keto propozime te marrin formen e nje konvente nderkombetare,

Miraton ditën e 20 qershorit 1996, konventën e mëposhtme, e cila do të quhet Konventa mbi Punën në Shtëpi, 1996.

Neni 1

Per qëllime të kësaj Konvente:

a) shprehja "punë në shtëpi" do të thotë llje pune që një person i caktuar si punonjës në shtëpi

-në shtëpi dhe e tij ose në lokale të tjera sipas zgjedhjes së tij, ndryshe nga lokaliteti dhe punës së punedhësit;

-me shperblim;

-me qëllim realizimin e një produkti apo të një shërbimi që i përgjigjet specifikave të punedhësit, cilado që të jetë prejardhja e pajisjes, materialeve ose elementeve të tjera të përdorur për këto qëllime;

vetëm nëse ky person nuk ka shkallën e nevojshme të autonomisë dhe pavarësisë ekonomike që të konsiderohet si punonjës i pavarur sipas legjislacionit kombëtar ose vendimeve të drejtësisë;

b) një person që ka cilësinë e rrogëmarrësit nuk quhet punonjës në shtëpi sipas kësaj Konvente, për të vetmin fakt se ai e kryen rastesisht punën e tij prej rrogetari në shtëpi dhe jo në vendin e tij të zakonshëm të punës;

c) termi "punedhës" tregon çdo person fizik apo juridik, i cili, drejtpërdrejt apo me ndërmjetes, ekzistenca e kësaj të fundit është ose jo e parashikuar nga legjislacioni kombëtar, jep punë në shtëpi për llogari të ndërmarrjes së tij .

Neni 2

Kjo Konvente zbatohet ndaj çdo personi që kryen një punë në shtëpi sipas nenit më sipër .

Neni 3

Çdo Anëtar që ratifikon këto Konvente duhet të miratojë, zbatojë dhe rishikojë në mënyrë periodike politikën kombëtare mbi punën në shtëpi, duke synuar përmirësimin e gjendjes së punonjësve në shtëpi, në konsultim me organizatat me të përfaqësuara të punedhësve dhe punëmarrësve dhe, kur ato ekzistojnë, me organizatat që merren me punonjësit e shtëpisë dhe me ato të punedhësve që përdorin punonjës në shtëpi.

Neni 4

1. Politika kombëtare mbi punën në shtëpi duhet të nxisë, sa më shumë që të jetë e mundur , barazinë e trajtimit ndërmjet punonjësve në shtëpi dhe punonjësve të tjerë rrogetarë, duke pasur parasysh karakteristikat e veçanta të punës në shtëpi, si dhe, nëse duhet, kushte të zbatueshme ndaj një tipi pune të njëjtit ose të ngjashëm të kryer në ndërmarrje.

2. Barazia në trajtim duhet të nxitet në mënyrë të veçantë përsa i përket:

- a) te drejtes se punonjesve ne shtepi per te krijuar apo anetaresuar ne organizata sipas deshires se tyre dhe per te marre pjese ne aktivitetet e tyre;
- b) mbrojtjes kunder diskriminimit ne punesim dhe profesion;
- c) mbrojtjes ne fushen e sigurise dhe shendetit ne pune;
- d) shperblimit;
- e) mbrojtjes prej regjimeve legale te sigurimeve shoqerore;
- f) aksesit per t'u formuar;
- g) moshes minimale te pranimit ne punesim apo pune;
- h) mbrojtjes se memesise.

Neni 5

Politika kombetare mbi punen ne shtepi duhet te vihet ne jete me ane te legjislacionit, kontratave kolektive, vendimeve te arbitrazhit ose me çdo menyre tjeter te pershtatshme, ne perputhje me praktiken kombetare.

Neni 6

Duhet te merren masat e duhura ne menyre qe statistikat e punes te mbulojne, brenda mundesive, punen ne shtepi.

Neni 7

Legjislacioni kombetar ne fushen e sigurise dhe shendetit ne pune duhet te zbatohet ndaj punes ne shtepi, duke marre ne konsiderate karakteristikat e saj dhe duhet te percaktohen kushtet ne te cilat disa tipe punesh dhe perdorimi i disa substancave rnund, per arsye te sigurise dhe te shendetit, te behen objekt ndalimi, per qellimet e punes ne shtepi.

Neni 8

Kur eshte e pranueshme per te perdorur ndermjetesit per qellimet e punes ne shtepi, pergjegjesite respektive te punedhenesve dhe ndermjetesve te jene te saktesuara, ne perputhje me praktiken kombetare, me rruge ligjore ose vendime te drejtesise.

Neni 9

1. Nje sistem inspektimi i pajtueshem me legjislacionin dhe praktiken kombetare duhet te siguroje respektimin e legjislacionit te aplikueshem ndaj punes ne shtepi.
2. Masa te pershtatshme, duke perfshire, nese duhet, sanksione, duhet te parashikohen dhe zbatohen me efektivitet ne rast shkelje te ketij legjislacioni.

Neni 10

Kjo Konvente nuk prek dispozita me te favorshme te konventave te tjera nderkombetare, qe jane te zbatueshme ndaj punonjesve ne shtepi.

Neni 11

Ratifikimi zyrtar i kesaj Konvente do t'i komunikohet Drejtorit te pergjithshem te Zyres Nderkombetare te Punes dhe do te regjistrohet prej tij .

Neni 12

1. Kjo Konvente eshte e detyrueshme per a:to vende anetare te Organizates Nderkombetare te Punes, ratifikimi i te ciles eshte regjistruar nga Drejtori i pergjithshem i Zyres Nderkombetare te Punes.

2. Ajo do te hyje ne fuqi 12 muaj pas dates kur eshte bere regjistrimi i ratifikimit te dy Anetareve nga Drejtori i pergjithshem.

3. Me pas, kjo Konvente do te hyje ne fuqi per çdo Anetar 12 muaj nga data ne te cilen do te jete regjistruar ratifikimi i saj .

Neni 13

1. Çdo Anetar qe ka ratifikuar kete Konvente mund ta denoncoje ate ne mbarim te nje periudhe dhjetevjecare pas dates se hyrjes ne fuqi per here te pare te Konventes, me nje akt qe i komunikohet Drejtorit te pergjithshem te Zyres Nderkombetare te Punes dhe te regjistruar prej tij. Denoncimi do te marre fuqi vetem nje vit pasi te kete qene i regjistruar .

2. Çdo Anetar qe ka ratifikuar kete Konvente, i cili, brenda afatit prej nje viti pas mbarimit te periudhes dhjetevjecare te permendur ne paragrafin e mesiperme nuk do te perdore te drejten e denoncimit te parashikuar ne kete nen, do te lidhet per nje periudhe te re dhjetevjecare dhe, me pas, do te mund ta denoncoje kete Konvente ne mbarim te cdo periudhe dhjetevjecare ne kushtet e parashikuara ne kete nen.

Neni 14

1. Drejtori i pergjithshem i Zyres Nderkombetare te Punes do t'i njoftoje te gjitha Anetareve te Organizates Nderkombetare te Punes regjistrimin e te gjitha ratifikimeve dhe denoncimeve, te cilat do t'i jene komunikuar atij nga Anetaret e Organizates.

2. Duke u njoftuar Anetareve te Organizates regjistrimin e ratifikimit te dyte qe do t'i jete komunikuar atij, Drejtori i pergjithshem do te terheqe vemendjen e Anetareve te Organizates mbi daten ne te cilen kjo Konvente do te hyje ne fuqi.

Neni 15

Drejtori i pergjithshem i Zyres Nderkombetare te Punes do t'i komunikojte Sekretarit te pergjithshem te Kombeve te Bashkuara, per qellime regjistrimi, ne perputhje me nenin 102 te Kartes se Kombeve te Bashkuara, te dhena te plota lidhur me te gjitha ratifikimet dhe aktet e denoncimeve qe ai do te kete regjistruar ne perputhje me nenet e mesiperme.

Neni 16

Sa here qe da ta gjykaje te nevojshrne, Keshilli Administrativ i Zyres Nderkambetare te Punes da t'i paraqese Kanferences se pergjithshrne nje rapart mbi zbatimin e kesaj Kanvente dhe da te shqyrtaje, nese duhet te regjistrahret ne rendin e dites te Kanferences, ceshtja e rishikimit te saj te plate ase te pjesshem.

Neni 17

1. Ne rastin kur Konferenca do te miratoje nje konvente te re, qe ben rishikim total ose te pjesshem te kesaj Konvente, dhe nese konventa e re nuk parashikon ndryshe:

a) ratifikimi nga nje Anetar i konventes se re qe ndryshon do te sillte me plot te drejte, pavaresisht nga neni 13 me siper, denoncimin e menjehershem te kesaj Konvente, me kusht qe konventa e re qe ndryshon kete Konvente, te kete hyre ne fuqi;

b) Duke u nisur nga data e hyrjes ne fuqi te konventes se re qe ndryshon, kjo Konvente do te pushoje se qeni e hapur per ratifikim per Anetaret.

2. Kjo Konvente do te mbetet megjithate ne fuqi ne formen dhe permbajtjen e saj per Anetaret, te cilet do ta kishin ratifikuar dhe qe nuk do te ratifikonin konventen qe ndryshon rishikim.

Neni 18

Versionet ne frengjisht dhe anglisht re tekstit te kesaj Konvente jane te barasvlefshme.